



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 547/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET ankesa si e pabazuara e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjektit politik PDK, me te cilën pretendohet se subjekti politik LDK në Podujevë, ka falsifikuar 200 bexha dhe në përmes simpatizantëve të saj ka ndikuar tek qytetarët me rastin gjatë ditës së votimit, po ashtu në ankesë theksohet se subjekti politik i lartcekur ka falsifikuar një numër të madh të fletëvotimeve. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi dhe një incizim.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se është bërë shkelja e theksuara në ankesë është e pabazuara nga shkaku se dëshmitë e ofruar nuk janë të asaj natyre për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 547/2010 më datën 15.12.2010.

